



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik/Municipality of Kačanik
Zyra e Kryetarit



01-NR-104/02-7020/19

Në mbështetje të nenit 13 dhe 58 (c), të Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 8 paragrafi 3.2 të Rregullores së Ministrisë të Financave Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, Kryetari i Komunës së Kaçanikut shpall këtë:

**THIRRJE PUBLIKE PËR SHPREHJE TË INTERESIT PËR TË QENË PJESË E KOMISIONEVE
VLERËSUESE PËR VLERËSIMIN E PROJEKTPROPOZIMEVE TË OJQ-VE**

Komuna e Kaçanikut gjatë vitit 2019, planifikon që përmes thirrjes publike të ofrojë mbështetje financiare për implementimin e projekteve të organizatave joqeveritare në fushat prioritare të cilat janë të planifikuara për vitin 2019.

Rregullorja MF - Nr - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, në nenin 8, paragrafi 3.2 parasheh që pjesë e çdo komisioni vlerësueses për vlerësimin e projektpropozimeve të OJQ-ve të pranuar sipas thirrjeve publike, duhet të jenë dy përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm, duke përfshirë përfaqësues të OJQ-ve. Për këtë qëllim, Komuna e Kaçanikut fton të gjithë kandidatët e interesuar që të aplikojnë për të qenë pjesë e regjistrit të ekspertëve të jashtëm, të cilët sipas nevojës së institucionit do të caktohen në cilësinë e anëtarëve në komisione vlerësuese për të vlerësuar projektpropozimet e dorëzuara nga OJQ-të për financim përmes fondeve publike.

Të drejtë aplikimi kanë:

- Të punësuarit në organizatat joqeveritare aktive në Republikën e Kosovës;
- Ekspertë të pavarur, të cilët kanë të paktën 5 vite përvojë pune që ndërlidhet me administratën publike, hartimin dhe menaxhimin e projekteve apo fusha të ngjashme.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- Duhet të kenë të kryer së paku nivelin e studimeve Bachelor;
- Të kenë të paktën 5 vite përvojë pune;
- Të kenë përvojë në projektet e OJQ-ve;
- Të mos jenë të emëruar politik, shërbyes civil apo pozita të ngjashme në administratën shtetërore.

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Një letër motivimi;
- Një CV të përditësuar;
- Dëshmi për shkollimin dhe përvojën e punës;
- Të punësuarit në OJQ duhet të dorëzojnë një letër nominimi nga udhëheqësi i OJQ-së në të cilën aplikuesi është i punësuar.

Aplikimi mund të bëhet jo më larg se data 20/03/2019, duke dorëzuar një kopje fizike të dokumentacionit të kërkuar në Qendrën Komunale, sporteli 4.

Komuna e Kaçanikut do të vlerësojë të gjitha aplikacionet e pranuar dhe kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara përmes kësaj thirrje publike do të bëhen pjesë e regjistrit të ekspertëve të jashtëm të cilët do të ftohen sipas nevojës për të qenë pjesë e komisioneve vlerësuese.



Kryetari i Komunës
z. Besim ILAZI